



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71014-00901-11-2017	Data e Regjistrimit	6/16/2017
Numri i Vendimit	11-2017-3979	Data e Vendimit	7/31/2017

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Paulin Çera

ANËTAR

SEKRETARE Entila Shkurti

Objekti: Përfitim nga amnistia.

Baza Ligjore : Ligji nr.141/2016 "Për dhënie amnsitie".

Përmbledhja e vendimit:

.

Vëren:

Kërkuesi, Ilir Jashari i është drejtuar Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesën për përfitim nga amnistia, sipas ligjit Nr. 141/2016, konkretisht sipas parashikimeve të nenit 5, pika b) e këtij ligji.

Për gjykimin e kësaj kërkesë, Gjykata caktoj seancën në datë 14.07.2017. në këtë seancë kërkuesi nuk u paraqit dhe për arsye shëndetësore kërkoi caktimin e seancës në një datë tjetër. Këtë vullnet kërkuesi e shprehu nëpërmjet deklaratës për mospjesëmarrje në gjykim, datë 14.07.2017. Gjykata e morri në konsideratë këtë kërkesë dhe vendosi që seanca e radhës të zhvillohet në datë 27.07.2017. Edhe në këtë seancë kërkuesi nuk u paraqit. Ai depozitojë në gjykatë deklaratën e datës 27.07.2017 duke shfaqur vullnetin për mosparaqitje në gjykim dhe përfaqësimin e tij ta realizonte avokat Ilia Ilia. Me fletë thirrjen Nr. 346 akti, datë 17.07.2017 është njoftuar avokat Ilia Ilia i cili nga ana e tij, veç marrjes dijëni për seancën gjyqësore ka bërë shënimin si vijon: *"Në emër të klientit tim dhe duke shprehur vullnetin e tij, heqim dorë nga kërkimi"*. Nga ana e përfaqësuesit të organit të akuzës nuk pati kundërshtim, ndërsa përfaqësuesi i IEVP Durrës u shpreh se e lë në çmim të gjykatës.

Gjykata duke parë qëndrimin e kërkuesit në dy seanca radhazi si dhe duke vlerësuar kërkesën e mbrojtësit të zgjedhur prej tij, vlerëson se është vendi për pushimin e gjykimit të kësaj çështje, pasi kërkuesi nuk ka interes për vazhdimin e saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Gjykata, pasi pa nenit 387/2 të K.Pr.Penale

Vendosi:

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes penale Nr. Regj. Them.(71014-00901) 346, datë regjistrimi 16.06.2017, që i përket kërkuesit **Ilir Jashari** me objekt: "Përfitim nga Amnistia", për shkak të heqjes dorë nga gjykimi.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Durrës.

U shpall në Durrës, sot më datë 27 Korrik 2017.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.